




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ZVEÇANIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Zveçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Zveçanit (Komuna e Zveçanit), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Zveçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Mangësi në prezantimin e të dhënave në PFV.

B2 Mos regjistrimi i pasurive.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Zveçanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A1 Zotim i mjeteve dhe urdhërblerja me vonesë.
- B3 Mungesa e dëshmive për vijueshmëri në punë.
- B4 Mos zbatimi i ligjit për mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Zveçanit.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Zveçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Zveçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Zveçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Zveçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmiresim të mundshëm, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në kontekst të sistemeve financiare, fushat ku janë identifikuar dobësi me të theksuara janë: përgatitja e PFV-ve jo në pajim me kërkesat ligjore, mos menaxhim i duhur i pasurive jo financiare, mangësi në menaxhimin e të hyrave dhe zotim i mjeteve dhe urdhërblerja me vonesë, të cilat janë paraqitur me poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshem të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësohen kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, një i ri dhe katër të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Mangësi në prezantimin e të dhënave në PFV

**Gjetja** Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajne registra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare". Nga rishikimi i PFV-e kemi vërejtur se ato nuk i prezantojnë të gjitha informatat financiare për periudhën raportuese dhe periudhën krahasuese si dhe shpalosjet përkatëse. Disa nga mangësit e identifikuar janë:

- Pasuritë jo financiare me vlerë mbi 1,000€ të prezantuara në pasqyrat fianciare nuk janë të mbeshtetura me raporte të SIMFK-së. Bazuar në "Raporti i vlerësimit të pasurive sipas klasës dhe institucionit" të nxjerrur nga SIMFK, vlera në libra e pasurive është 3,503,498.63 €, ndërsa në PVF vlera e pasurive është paraqitur 3,528,440.74 €;
- Komuna nuk i ka të regjistruara pasuritë jo financiare me vlerë nën 1,000€ dhe stoqet si dhe nuk janë prezantuar në pasqyrat fianciare; si dhe
- Mungojnë informatat për llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet kontigjente; si dhe
- Nuk është bërë inventarizimi i pasurive.

Sipas zyrtarëve komunal kjo ka ndodhur për arsye të mungesës së informatave financiare të trasheguara nga qeverisja paraprake, pamundësisë së zyrtarëve aktual për t'i konsoliduar të gjitha këto informacione brenda periudhes kohore deri në raportim, si dhe vështërsive për të rekrutuar staf profesional dhe për t'i funksionalizuar sistemet përkatëse informative për sigurimin e informatave financiare dhe jo financiare.

**Ndikimi** Mangësit në prezantim të PFV-ve, pamundësojnë që lexuesit të kuptojnë gjendjen e saktë të Komunes. Po ashtu, mungesa e informatave të plota në shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare ndikon në paraqitje jo të drejtë

dhe të vërtetë të pasqyrave financiare.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se PFV për vitin 2024 janë të plota dhe të sakta, si dhe janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme për përgatitjen e tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Mos regjistrimi i pasurive**

**Gjetja** Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, neni 6, përcakton që: çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Më tej, potencohet se regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ të cilat duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në sistemin E pasuria.

Në vitin 2023, Komuna nuk kishte krijuar regjistër të pasurive nën dhe mbi 1,000€ dhe nuk i kishte prezantuar ato në pasqyrat financiare.

Kjo ka ndodhur për arsye të dorëheqjes së stafit në rrethanat e krijuara dhe pamundësisë për të rekrutuar stafin e ri në periudhën e mbetur kohore për raportim.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i të gjitha pasurive të Komunës në regjistrat e pasurive, ndikon në mungesë të informatave të menaxhmentit në lidhje me pasuritë që posedon komuna, dhe paraqet mos përmbushje të kërkesave ligjore në lidhje me evidentimin e pasurive. Po ashtu kjo ndikon në shpallje të pasaktë të informatave për pasuritë në PFV.

**Rekomandimi B2** Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar, vlerësuar dhe regjistruar në regjistrat përkatës, për siguruar që prezantimi i informatave për pasuritë në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Zotim i mjeteve dhe urdhërblerja me vonesë

**Gjetja** Rregulla financiare Nr.01/2013, neni 22, përcakton hapat për procedim të pagesave, ku fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje (zotimi i mjeteve), të procedohet urdhërblerja, pastaj pranimi i mallit, pastaj pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Gjatë testimi të pagesave kemi vërejtur që zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja ishte lëshuar dhjetë (10) ditë pas pranimit të faturës, vlera e të cilës ishte 13,8740.40€. Përveç kësaj kemi vërejtur së urdhërblerja nuk janë të nënshkruara dhe nuk e përmbajnë datën e saktë të gjenerimit të tyre.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.

**Ndikimi** Zotimi i mjeteve dhe procedimi i urdhërbljerjeve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhërbljesave për furnizim, shërbime apo fillim të punëve.

**Rekomandimi A1** Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B3 - Mungesa e dëshmive për vijueshmëri në punë

**Gjetja** Sipas Nenit 9 të Rregullores (QRK) nr. 07/2022 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publik “Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni”.

Nga mostrat e audituara kemi vërejtur se regjistrimi i ardhje/vajtjes së punëtorëve nga puna është bërë në lista ditore për ardhje/vajtje dhe disa zyrtarë nuk ishin evidentuar në këto lista. Komuna nuk ka një sistem elektronik për të mbajtur evidence për ardhje/vajtje në punë për punonjësit e saj.

**Ndikimi** Mungesa e dëshmive për praninë e këtyre punonjësve në punë, paraqet kontroll të dobët mbi menaxhimin e stafit dhe mundësinë e pagesave të parregullta ose fiktive për punonjësit që nuk respektojnë orarin e punës.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronik.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### **Çështja B4 - Mos zbatimi i ligjit për mbledhjen e të hyrave nga tatimi në prone**

##### **Gjetja**

Neni 2 i ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme thotë qartë se çdo organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyrat nga tatimi në prone.

Në PFV të vitit 2023 komuna nuk ka paraqitur të hyra të mbledhura nga tatimi në pronë dhe nuk ka planifikuar të hyrat nga tatimi në pronë as në buxhetin e vitit 2024.

Kjo ka ndodhur për faktin se nga qeverisja e kaluar nuk kanë trashëguar regjistër të pronave dhe procedura tjera për mbledhjen e tatimit në prone, ndërsa menaxhmenti aktual në mungesë të zyrtarëve nuk ka mundur të ndër marr veprime të tilla.

Gjatë vitit 2023 komuna nuk ka filluar të ndër marr veprime për identifikimin dhe regjistrimin e pronës, për arsye të mungesës së stafit.

##### **Ndikimi**

Mos zbatimi i Ligjit dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimit në pronë, ka ndikim të rëndësishëm dhe ndikon drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve të komunës. Mungesa e regjistrimit të pronave ia pamundëson komunës identifikimin e pronave të saj dhe mbledhjen e të hyrave që janë bazë e financimit.

##### **Rekomandimi B4**

Kryetari duhet të ndër marr veprime për funksionalizimin e shërbimit të tatimit në pronë, hartimin e një rregulloreje të brendshme për përcaktimin e shumës së tarifave dhe gjithashtu përmes komunikimit të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e tatimit në pronë dhe përfitimet që kanë qytetarët prej tij.

##### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>2,737,405</b>	<b>891,990</b>	<b>681,444</b>	<b>1,846,175</b>	<b>2,192,035</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	2,697,405	788,118	681,444	1,752,467	1,782,867
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	27,594	5,985
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	0	0	0	388,783
Të bartura nga viti i kaluar	0	0	0	46,755	0
Të hyrat vetanake	40,000	40,000	0	19,358	0
Donacionet e jashtme	0	63,871	0	0	14,400

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikeve të mëposhtëm:

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,845,415€. Në vitin 2023, Komuna kishte shpenzuar 76% të buxhetit final ose 681,444€. Shpenzimet e vitit 2022 janë dukshëm më të larta dhe kjo është pasojë e gjendjes politike. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>2,737,405</b>	<b>891,990</b>	<b>681,444</b>	<b>1,846,175</b>	<b>2,192,035</b>
Pagat dhe mëditjet	1,504,234	550,922	530,615	1,192,194	1,277,699
Mallrat dhe shërbimet	320,000	205,613	140,595	194,322	242,129
Komunalitë	60,000	7,234	7,234	5,666	5,035
Subvencionet dhe transferet	92,880	43,000	3,000	126,755	98,477
Investimet Kapitale	760,291	85,220	0	327,238	568,694

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe medijtje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 953,312€.  
Shpenzimet në këtë kategori ishin afro 96% e buxhetit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 114,387€. Në këtë kategori shpenzimet ishin afro 68% e buxhetit;
- Buxheti final për shërbimet komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 52,766€. Të kjo kategori, shpenzimi i buxhetit ishte 100%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 49,880€. Shpenzimet ishin afro 7% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 675,071€. Komuna nuk ka bërë investime kapitale dhe nuk ka shpenzime në këtë kategori buxhetore.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat jo tatimore të realizuara nga komuna në 2023 ishin në vlerë 1,336€. Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2022, ishin më të ulëta për 15.2% apo për 239€.


Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>40,000</b>	<b>40,000</b>	<b>1,336</b>	<b>1,575</b>	<b>2,196</b>
Të hyrat jo tatimore	40,000	40,000	1,336	1,575	2,196

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Këto të dhëna nuk mund të plotësohen sepse në vitin 2022 për shkaqe politike nuk është realizuar auditimi i PVF për vitin 2022.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të shtojë kontrollet gjatë përgatitjes së PVF-ve në mënyrë që shpalosjet në PVF për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e lëshuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë kryer të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.	Nuk janë ndërmarr veprime	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Ligjeve për mbledhjen e të hyrave, të cilat kanë për qëllim zbatimin e kërkesave ligjore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Në të njëjtën kohë, Kryetari duhet të fillojë menjëherë iniciimin për hartimin e një rregulloreje të brendshme për tatimet, tarifat dhe taksat e qytetarëve për shërbimet komunale.	Nuk janë ndërmarr veprime	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronikë, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore, në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.	Nuk janë ndërmarr veprime	Nuk ka filluar zbatimin

4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që përdorimi i automjeteve dhe mbajtja e evidencave për përdorimin dhe shpenzime të karburantit të bëhet sipas kërkesave të UA, si dhe të aprovoj draft-rregulloren për përdorimin e automjeteve zyrtare.	Nuk janë identifikuar gjetje të tilla.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë do të rishikojë bazën ligjore të kontratës dhe se për të gjitha shpenzimet që kërkojnë procedura të prokurimit në përputhje me rregullat, do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik dhe LMFP.	Nuk janë identifikuar gjetje të tilla.	I zbatuar
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që Rregullorja për Subvencionet të përditësohet, si dhe të forcojë kontrollet për të siguruar monitorim efektiv të përdorimit të mjeteve të ndara nga buxheti komunal.	Nuk janë identifikuar gjetje të tilla.	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë të ndërmerren të gjitha veprimet për të siguruar që shpenzimet të planifikohen në ndarjet apo rialokimet e duhura buxhetore dhe që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në përputhje me kodet përkatëse ekonomike.	Nuk janë identifikuar gjetje të tilla.	I zbatuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të ndërmarr hapa në përputhje me Rregulloren për financimin publik të i OJQ-ve me thekse të veçantë në raportimin e përfituesve për shpenzimin e fondeve publike.	Nuk janë identifikuar gjetje të tilla.	I zbatuar
9.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim, në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherësh duhet të siguroj që është vënë në përdorim sistemi e-pasuria.	Nuk janë ndërmarr veprime për regjistrimin e pasurive jofinanciare.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet komunale i nënshtrohen auditimit të brendshëm, për të pranuar një vlerësim të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rizikut dhe proceseve të kontrollit.	Nuk janë ndërmarr veprime	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.  
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Komuna e Zvečanit  
Opština Zvečan  
Zvečan Municipality



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Zvečanit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe kam e për përmbajtjen e Raportit;
- komentet do të dërgojme në afatit e paraparë brenda 30 dite nga pranimi i Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z.Illir PEÇI

Keyetar i Komunës së Zvečanit

Data: 20.06.2024



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.